



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria e statistikës

Shkup, 30 prill 2025

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: mars 2025

- Në mars 2025, norma mesatare e interesit të totalit të kredive është ulur në nivel mujor dhe vjetor për 0,03 p.p., respektivisht 0,35 p.p., dhe shënon 5,15%. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave shënon 2,18% dhe është ulur për 0,01 p.p., përderisa në nivel vjetor është rritur për 0,38 p.p.
- Norma mesatare e interesit të kredive të reja², në mars, shënon 4,26% dhe shënon rënie mujore dhe vjetore prej 0,37 p.p. dhe respektivisht 0,72 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja është ulur në bazë mujore dhe vjetore për 0,17 p.p., respektivisht 0,22 p.p., dhe është 2,24%.

Tabela 1 Normat e interesit të depozitave dhe kredive të reja në total

	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024	9.2024	10.2024	11.2024	12.2024	1.2025	2.2025	3.2025
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44	5.41	5.38	5.36	5.30	5.21	5.18	5.15
Korporatat	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20	5.15	5.09	5.05	4.96	4.85	4.82	4.77
Amviseritë	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66	5.66	5.66	5.66	5.63	5.55	5.53	5.51
Kreditë e reja	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04	4.98	4.81	4.82	4.42	4.70	4.63	4.26
Korporatat	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90	4.78	4.65	4.68	4.39	4.65	4.45	3.95
Amviseritë	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28	5.27	5.17	5.03	4.47	4.76	4.81	4.69
Depozitat	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96	2.01	2.07	2.12	2.17	2.18	2.19	2.18
Korporatat	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20	2.34	2.42	2.68	2.69	2.69	2.71	2.65
Amviseritë	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93	1.97	2.02	2.05	2.10	2.11	2.12	2.12
Depozitat e reja	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43	2.60	2.84	2.80	2.78	2.48	2.41	2.24
Korporatat	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99	2.14	2.75	2.43	2.59	2.56	2.49	2.14
Amviseritë	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76	2.79	2.89	2.88	2.83	2.46	2.38	2.28

Burimi: BPRM-ja.

¹ Me termin "normë interesi" nënkuptohet norma e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf

² Në lidhje me normat e interesit të kredive të sapo miratuara / depozitave të sapo pranuar janë karakteristike lëvizje të ndryshueshme. Lëvizjet e këtyre normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e re e rënë dakord e interesit.




Veriut

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së


Drejtoria e statistikës

1. Norma të interesit në sektorin korporativ³


- Këtë muaj, norma mesatare e interesit e totalit të kredive të sektorit korporativ është 4,77% dhe është më e ulur për 0,05 p.p. në bazë mujore. Kështu, ndryshimi mujor del nga rënia e normave të interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,14 p.p. respektivisht 0,04 p.p.) dhe të normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,03 p.p.). Në krahasim me marsin e vitit të kaluar, kjo normë e interesit është më e ulët për 0,58 p.p.




Burimi: BPRM-ja.



- Në mars, norma e interesit e kredive të reja të sektorit korporativ është 3,95% dhe në bazë mujore u ul për 0,50 p.p. Ulja është rezultat i rritjes së normave të interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,58 p.p.), në kushte të rritjes së normave të interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore dhe të normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,22 p.p., respektivisht 0,18 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit është ulur për 0,78 p.p.



Burimi: BPRM-ja.



³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jofinanciare (publike dhe të tjera).




Veriut

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së


Drejtoria e statistikës

- Këtë muaj, te norma mesatare e interesit për totalin e depozitave të sektorit korporativ, është shënuar ulje mujore prej 0,06 p.p. dhe shënon 2,65%. Analizuar sipas valutës, ulja rezultoi nga ulja e normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,21 p.p.) dhe të normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,03 p.p.), përdërisa normat e interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore shënuan rritje prej 0,25 p.p. Analizuar në bazë vjetore, norma mesatare e interesit e depozitave totale të sektorit korporativ shënoi rritje prej 0,53 p.p.
- Në mars, norma e interesit e depozitave të reja⁴ të sektorit të korporatave është 2,14% dhe është zvogëluar për 0,35 p.p. në bazë mujore. Ulja mujore vjen si pasojë e uljes së normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,83 p.p.) dhe normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,22 p.p.). Këtë muaj, bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Në bazë vjetore, kjo normë interesi është zvogëluar për 0,38 p.p.

2. Normat e interesit të amvisërive⁵



Burimi: BPRM-ja.



- Norma e interesit të totalit të kredive të amvisërive, këtë muaj, shënon 5,51% duke shënuar ulje mujore prej 0,02 p.p. Rënia në bazë mujore del nga ulja e normave të interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,05 p.p. respektivisht 0,01 p.p.), me norma të pandryshuara të interesit të kredive në valutë të huaj. Në bazë vjetore, norma e interesit e totalit të kredive të amvisërive është ulur për 0,14 p.p.

⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave te normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.




Veriut


Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së

Drejtoria e statistikës

- Në mars, norma mesatare e interesit të kredive të reja të amvisërive, shënoi rënie prej 0,12 p.p. dhe është 4,69%. Ndryshimi rezulton nga rënia e të gjithë komponentëve, edhe ate: normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,35 p.p.) dhe normat e interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,13 respektivisht 0,05 p.p.). Analizuar në bazë vjetore, kjo normë interesi është ulur për 0,71 p.p.



Burimi: BPRM-ja.



- Këtë muaj, norma e interesit e totalit të depozitave të amvisërive është e pandryshueshme në raport me muajin e kaluar dhe shënon 2,12%. Në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënon rritje prej 0,36 p.p.
- Norma e interesit të depozitave të reja të amvisërive⁶, në mars, është 2,28% dhe shënoi rënie mujore prej 0,10 p.p. Ndryshimi në rënie është rezultat i rënies së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,12 p.p.) dhe normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,09 p.p.). Këtë muaj, bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të reja në denarë me klauzolë valutore. Në nivel vjetor, norma e interesit e depozitave të reja të amvisërive është më e ulët për 0,14 p.p.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Veriut

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së

Drejtoria e statistikës

Informacione mbështetëse

Seri kohore e të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendar i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 30 maj 2025 (mesatare referuese, përfshirë prillin e vitit 2025).

Për pyetje të gazetarëve, ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235. 108/110.